



*[Handwritten signature]*

Ne vijim VKKKP ish-Pronarëve.

Ne lidhje me Vendimin e Komisionit për Kthimin dhe Komisionin e Pronave Ish-Pronarëve nr.58 date 20 Dhjetor 1996 në favor të shtetasit Luc Lugaç Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër rezultoi të ketë hetuar dhe konstatuar

1996 në favor të shtetasit Luc Lugaç. date 28 Dhjetor 1998 në favor të shtetasit Prendush Vecaj dhe nr.58 date 20 Dhjetor Luk Gjeçaj, nr.13/1 date 28 Qershor 1995 në favor të trashëgimitarve Gjeçaj, nr.11/1 shtetasit Rrok Turmalaj, nr.13 date 30 Qershor 1994 në favor të shtetasve Drande e Maj 2001 në favor të shtetasit Nik Mark Pacaj, nr.07 date 18 Maj 2000 në favor të nr.19/2 date 21 Maj 2002 në favor të shtetasit Nik Gjergj Purashaj, nr.20 date 21 të Pronave, ish-Pronarëve, Malësi e Madhe janë marrë ndër të tjera edhe vendimet Nga hetimet e kryera ka rezultuar se nga ana e Komisionit të Kthimit dhe Komisionit

veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. dokumentave" parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe "Pastrimi i produkteve të penal nr.421 date 10 Mars 2016 për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër ka regjistruar procedimin

**KONSTATOVA:**

Shkodër pasi studiova aktet e procedimit penal nr.421 date 10 Mars 2016; Unë **Bleria Hamza**, Prokurorë në Prokurorinë e Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Në Shkodër, sot më 23 Prill 2018.

**"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE"**

**KËRKESË**

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISE



faktin që ai është i falsifikuar dhe ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. 424 të vitit 2007 ku në përfundim të procesit gjyqësor të zhvilluar Gjykatata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër me vendimin nr.448 datë 10 Dhjetor 2008 ka vendosur: "Deklarimin fajtor të shtetasit Luc Prek Lugaj për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumentave" parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal....."

Nga hetimet e kryera në lidhje me dhënien e VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 në favor të shtetasit Nik Gjergj Purashaj, nr.20 datë 21 Maj 2001 në favor të shtetasit Rrok Turmalaj, nr.13 datë 30 Qershor 1994 në favor të shtetasve Drande e Luk Gjetja, nr.13/1 datë 28 Qershor 1995 në favor të trashëgimtarve Gjetja dhe nr.11/1 datë 28 Dhjetor 1998 në favor të shtetasit Prendush Vecaj ka rezultuar se vendimi nr.19/2 datë 21 Maj 2001 në favor të shtetasit Nik Gjergj Purashaj dhe vendimi nr.20 datë 21 Maj 2001 në favor të shtetasit Nik Mark Pacaj janë të falsifikuar pasi janë marrë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Konkretisht, me anë të VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 komisioni për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve i përbërë nga shtetasit Tom Curti, kryetar, Col Gjoni, nënkryetar, Rita delaj, Ruzhdi Handraj dhe Faik Kurtulaj, anëtarë, janë mbledhur në datën 25 Maj 2001 dhe kanë marrë në shqyrtim kërkesën e shtetasit Nik Gjergj Purashaj për kthimin e pronave të tij pyll. Në zbatim të nenit 7/1,7/2,7/3 të ligjit nr.7699 datë 21 Prill 1993 komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin në dosjen nr.169 datë 18 Gusht 2000 të pronarit Nik Gjergj Purashaj konstatoi se dokumentacioni është dorëzuar në zbatim të nenit 7/1 të ligjit nr.7699 datë 21 Prill 1993 dhe përmbush kërkesat e nenit 5/1 të ligjit si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.560 datë 16 Tetor 1995. Bazuar në vërtetimin e pronës së të gjëndjes kadastrale të lëshuar në datën 13 Tetor 2000 i cili shogërohet me planvendosjen përkatese të lëshuar nga kjo zyrtë komisioni konstatoi se pronat e kërkuar nuk ka pësuar ndryshime në gjëndjen kadastrale të datës 01 Gusht 1991, si dhe në bazë të vërtetimit të lëshuar nga kadastra është pyll. Nisur nga përcaktimet e



*[Handwritten signature]*

mësipërme në zbatim të nenit 7/2 të ligjit nr.7699 datë 21 Prill 1993 komisioni vendosi **a)** të njohtë në pronësi të pronarit ligjor të këtyre pronave z.Nik Gjergj Purashaj sipërfaqen e pyllit prej 35 006 m2 (tridhjet e pesë mijë e gjashtë) pyll, si më poshtë:

1- Parcelat me numër 74, 75, 84, 87, 91 me sipërfaqe 6349 (gjashtë mijë e treqind e katërdhjet e nëntë) m2 të cilat kufrizohen: nga Veriu me shtetin, nga jugu me Gjon Gropçin, Lindja me shtetin, nga Perëndimi me rrugën Razëm-Fushëzeze.  
2-Parcela me numër 68 me sipërfaqe 4657 (katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) m2 që kufrizohet: nga Veriu me rrugën e kampit, hoteli furra e vjetër, nga jugu me kryqëzimin e rrugëve para PTT, nga Lindja me rrugën që të çon tek shtëpia e Ejll Babës,nga Perëndimi me rrugën që të çon tek pusat.

3-Parcelat me numër 211, 211/1 me sipërfaqe 22000 (njëzet e dy mijë) m2 që kufrizohet: nga Veriu me pronat e Kishës, nga jugu me hotelin e vjetër, nga Lindja me fushën e Sportit të komunës, nga Perëndimi me rrugën Razëm Fushë e zeze.  
b) Të kthejë në natyrë pronarit të ligjshëm Nik Gjergj Purashaj sipërfaqen e pyllit prej 35 006 (tridhjetë e pesëmijë e gjashtë) metra katror pyll e cila në bazë të nenit 7/1 të ligjit nr. 7699 i kthehet pronarit.<sup>2</sup>

Nga shqyrtimi i këtij vendimi rezulton se ai është i shkruar me kompjuter, numri dhe data janë plotësuar me stilolaps me ngjyrë blu, vitit i marrje së tij është korigjuar nga 2002 në 2001, është vulosur me vulën e njomë rrethore të Prefekturës së Qarkut Shkodër, në të ka firmosur vetëm kryetari Tom Curri ndërsa nënkryetari dhe antarët e tjerë nuk kanë firmosur, prona i është kthyer vetëm shtetasit Nik Gjergj Purashaj ndërkohë që rezulton se ky i fundit ka lindur në vitin 1948 dhe ka edhe katër vëllezër të tjerë, pra, nuk është gelur dëshmia e trashëgimisë për të ndjerin Gjergj Purashaj dhe është i pa shogëruar me planvendosjen përkatëse.

Nga korespondenca e mbajtur me Agjensinë e Trajtimit të Pronave, Tiranë rezulton se pranë saj nuk ndodhet i administruar VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 në formën e tij origjinale, por një fotokopje e këtij vendimi është gjetur në dosjen e Vendimit nr.17 datë 29 Korrik 1994 që i përket shtetasit Zef Cin Asha. Gjithashtu

<sup>2</sup> Cituar me ndryshime VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2001.



po nga korespondenca e mbajtur me Agjensinë e Trajtimit të Pronave, Tiranë dhe kqyrja e dokumentacionit të administruar pranë saj me qëllim shqyrtimin e librit të protokollit të KKKP ish-Pronarëve, Malësi e Madhe ka rezultuar se ky libër nuk gjendet.

E pyetur në dobi të hetimit shtetasja **Brianda Sekaj** ka deklaruar se ajo ka punuar si arkiviste në KKKP Shkodër nga muaji Gusht 2009 deri në muajin Prill 2010. Arkivën ia ka marrë në dorëzim shtetas Age Marashi dhe ia ka dorëzuar me procesverbal nr.245 datë 23 Qershor 2010 Agjensisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Tiranë. Ajo ka sqaruar se VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 ka gënë në dosjen e trashëgimitarëve Asha dhe ashtu është inventarizuar por se si është administruar ky dokument aty nuk ka dijeni. Gjatë hetimeve paraprake nuk është bërë e mundur pyetja e shtetas Age Marashi në lidhje me faktin e dorëzimit të dokumentacionit të KKKP ish-Pronarëve Malësi e Madhe në KKKP ish-Pronarëve, Shkodër pasi ajo ndodhet jashtë shtetit.

Nga shqyrtimi i disa prej vendimeve të dhëna nga KKKP ish-Pronarëve, Malësi e Madhe ndër vite konstatohet se nga viti 1993 deri në vitin 2001 nga ky komision janë dhënë 125 (njëqind e njëzet e pesë) vendime të cilat janë në rend kronologjik që do të thotë psh: se pas vendimit nr.80 datë 12.12.1999 vendimi i parë i marrë në vitin 2000 ka numrin 81. Disa prej vendimeve janë me fraksione por gjithmonë ato kanë lidhje me vendimin bazë i cili është një numër i plotë. Ky rregull dhe kjo kronologji nuk është e vërtetuar dhe për rrjedhojë respektuar në rastin e marrjes së vendimit nr.19/2 datë 21 Maj 2002 i cili nuk është në rend kronologjik me vendimin paraardhës dhe nuk ka lidhje fare me vendimin bazë që ka numrin 19 i cili nuk i përket as shtetasit Nik Gjergj Purashaj dhe as vitit 2002.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetas **Besnik Hysaj** ka deklaruar se ai është licencuar si ekspert inxhinier gjeodet që në vitin 2001. Ai ka sqaruar se planet e rilevimit të administruara në referencën 014 janë nënshkruar prej tij ndërsa rubrikat e tjera nuk janë plotësuar prej tij. Ai ka shkruar pjesën .....pasuria e pretenduar nga pronari ...por jo pjesën pasuria e kthyer . Ekziston mundësia që



këto plane rilevimi të jenë marrë nga kompania e cila ka bërë regjistrimit fillestar të zonës kadastrale ku ndodhet pasuria e kthyer shtetasit Nik Gjergj Purashaj të pa plotësuar por nuk është në dëgjim të faktit se kush e ka bërë këtë veprim apo kush i ka plotësuar ato. Deklaruesi ka sqaruar gjithashtu se planet e rilevimit nuk shërbejnë për regjistrimin e pasurisë pasi nuk janë planvendosje apo harta treguese që i bashkëlidhen titullit të pronësisë.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dëgjim për veprën penale shtetasit **Col Gjonaj** ka deklaruar se VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 në emër të shtetasit Nik Gjergj Purashaj nuk është marrë nga VKKKP ish-pronarëve, Malësi e Madhe pasi në asnjë rast nga ky komision nuk janë kthyer 35 000m<sup>2</sup> pyll në Razëm. Ky vendim është i falsifikuar pasi numri i tij nuk është i saktë, nuk është ruajtur rendi kronologjik i numërimit të vendimeve nga VKKKP ish-pronarëve dhe formulimi i tij nuk është sipas modelit të përdorur nga komisioni. Ky vendim rezultoi të jetë shkruar me kompjuter ndërkohë që nga viti 1993 deri në vitin 2001 asnjë prej vendimeve të komisionit nuk është shkruar me kompjuter por me makinë shkrimi prej tij ose shtetasit Faik Kurtulaj. Nga formulimi i këtij vendimi konstatohet se nuk përmendet asnjë dokument pronësie ku mbështeten pretendimet e kërkuarit pasi vërtetimi kadastral nuk është përdorur në asnjë rast si dokument për kthimin e pronës por këtë vërtetim pala e interesuar e paraqiste si provë në gjykatë dhe më pas vendimi i gjykatës shërben si dokument për kthimin e pronës. Deklaruesi ka sqaruar se mesa mban mend ai nga viti 1993 deri në vitin 2001 numri i vendimeve të VKKKP ish-pronarëve, Malësi e Madhe nuk e kalon shifrën 140.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dëgjim për veprën penale shtetasit **Tom Curri** ka deklaruar se në fund të vitit 2001 është suprimuar VKKKP ish-pronarëve Malësi e Madhe dhe dosjet i kanë lënë të mbyllura në zyrë. Zyrat e Këshillit të Rrethit, Malësi e Madhe i kanë kaluar më pas Bashkisë Koplik dhe firma që ka kryer punimet i ka hapur zyrat dhe dosjet i ka vendosur në një anë të cilat më vonë ka ardhur dhe i ka marrë përfaqësuesi i Prefekturës Zef Kodrina. Deklaruesi sqaron se VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 është firmosur prej tij por nuk jep sqarim se përse



nuk gjendet dosja e këtij vendimi dhe përse një kopje e këtij vendimi është inventarizuar dhe ndodhet në dosjen e vendimit nr.17 datë 29 Korrik 1994 të bashkëpronarëve Ashta. Gjithashtu, deklaruesi ka sqaruar se protokollin e mbledhjeve të komisionit e ka mbajtur Col Gjonaj dhe Rita Delaj ndërsa antarë të komisionit kanë qenë shtetasit Col Gjonaj, Rita Delaj, Faik Kurtulaj dhe Ruzhdi Handraj.

Sipas aktit të ekspertimit grafik nr. 7607 datë 14 Korrik 2017 të hartuar nga Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë rezultoi se : 1) Shenja e vulës së njomë rrethore me përmbajtje "REPUBLIKA E SHQIPËRISE-PREFEKTURA E QARKUT-RRETHI MALESI E MADHE", gjendur në krah të rekuizites "Kryelari" tek dokumenti i titulluar, "VENDIM" me Nr. 19/2, datë 21.05.2001 e KKKP, të rrethit Malesi e Madhe, është formuar nga e njëjta klishe vule që ka formuar edhe shenjat e vulave me të njëjtën përmbajtje të ndodhura në dokumentet modele të lira krahasimi të titulluara "Vendim" me Nr.46, datë 29.12.2000, i KKK Pronave të Rrethit Malesi e Madhe, dhe "Vendim" me Nr. 75, datë 25.04.2000, i KKK Pronave të Rrethit Malesi e Madhe. 2) Në rekuiziten "Nr " të gjendur poshtë titullit të dokumentit objekt ekspertimi, "VENDIM" me Nr. 19/2, datë 21.05.2001 e KKKP, të rrethit Malesi e Madhe, vija ndarëse dhe numri "2", janë plotësuar me të njëjtin mjet shkruar krahasuar midis tyre, por me mjet shkruar të ndryshëm krahasuar me shifren parardhese "19", dhe ato të gjendura në rubrikat e tjera. 3) Në rekuizitat "viti" të gjendura në dokumentin objekt ekspertimi të titulluar "VENDIM" me Nr. 19/2, datë 21.05.2001 e KKKP, të rrethit Malesi e Madhe, tek shifra "2001" poshtë shifres "1" ka qenë shkruar shifra "2"-2001(2). 4) Dorëshkrimi, që gjendet në pjesën e sipërme të skicës së dokumentit objekt ekspertimi të titulluar "Plan-Rivelimi", pa nr.—të pa plotësuar, është shkruar i shtetasit Hysaj, krahasuar me modelët eksperimentalë të shkruarit të marrë këtij shtetasi. 5) Në lidhje me pyetjen nëse dorëshkrimi i plotësimit të rubrikave të gjendura në dokumentin objekt ekspertimi të titulluar "Plan-Rivelimi" me nr.211 të pasurisë në emër të shtetasit Nik Purashaj, është shkruar ose jo nga shtetasi Besnik Hysaj, nuk mund të konkludohet.



Plan-

Ndërkohë, nga kqyrja e dokumentacionit të administruar në Zyren Vendore të regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Malesi e Madhe<sup>3</sup> rezulton se VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 në formën e tij origjinale ndodhet në referencën nr.014 të zonës kadastrale 3834. Bashkëlidhur tij nuk ndodhet planvendosja e miratuar nga organi kompetent që ka hartuar vendimin por ndodhen tre plane rilevimi, njëri për pasurinë nr.211, me sipërfaqe 22 000 (njëzet e dy mijë) m2, një tjetër për pasurinë nr.68/3 me sipërfaqe të pa pasqyruar dhe plani i tretë i rilevimit nuk ka asnjë të dhënë të pasurisë së kthyer ish-pronarit. Këto plane rilevimi janë hartuar nga eksperti inxhinier-gjeodet Besnik Hysaj dhe janë të vullosura me vulën e njomë të Rrethit të Malësisë së Madhe. VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 është regjistruar në përkatësisht në nr.hipotekor 166 datë 2 Dhjetor 2002 sipërfaqe 3600 m2 pyll, në nr.hipotekor 167 datë 2 Dhjetor 2002 sipërfaqe 2700 m2 pyll dhe në nr.hipotekor 169 sipërfaqe 22 000m2 pyll. Ky regjistrim është bërë pas aplikimit të shtetasit Nik Gjergj Purashaj në datën 2 Dhjetor 2002, fakt që provohet me nënshkrimin e tij në librin e pranimit të kërkesave për regjistrim dhe lëshim gertifikatash, vetëm në bazë të VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 bashkëlidhur të cilit nuk ndodhet dokumentacioni hartografik-teknik i lëshuar nga organi kompetent me qëllim identifikimin dhe pozicionimin e saktë gjeografik pronës në hartën treguese të regjistrimit si dhe sipërfaqen e saj. Pasuritë e regjistruara në nr.hipotekore 167,168, dhe 169 datë 2 Dhjetor 2002 janë regjistruar më pas në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe referuar kartelave të pasurive konstatohet se pas ndarjes së tyre ato janë tjetërsuar tek personat e tretë si më poshtë vijon:

- 1-pasuria nr. 74/3, vol.1, fq.84 me sipërfaqe 300m2, shitur shtetasit Fasil Smakaj;
- 2-pasuria nr.74/6, vol.1, fq.86 me sipërfaqe 250m2, shitur shtetasit Adil Zeka;
- 3-pasuria nr.74/7, vol.1, fq.87, me sipërfaqe 350m2 shitur shtetasit Florin Markaj;
- 4-pasuria nr.74/4, vol.1, fq.88, me sipërfaqe 900m2 shitur shtetasit Drian Zennuni;
- 5-pasuria nr.74/2, vol.1, fq.89, me sipërfaqe 300m2 shitur shtetasit Arif Bucaj;
- 6-pasuria nr.74/8, vol.1, fq.90 me sipërfaqe 200 m2 shitur shtetasit Albenc Dervishi;
- 7-pasuria nr.74/9, vol.1, fq.91 me sipërfaqe 200m2 shitur shtetasit Bujar Mataj;



7

*[Handwritten signature]*

8-pasuria nr.74/11, vol.1, fq.104, me sipërfaqe 350m2 shitur shtetasit Gjergj Boka;

9-pasuria nr.91, vol.1, fq.63, me sipërfaqe 27000 m2 shitur shtetasit Dritan Zenelaj;

10-pasuria nr.74/13, vol.1, fq.106, me sipërfaqe 100më shitur shtetasit Dritan Zenelaj;

11-pasuria nr.211/4, vol.1, fq.19, me sipërfaqe 1000m2 shitur shtetasit Martin Pllumbi;

12-pasuria nr.211/7, vol.1, fq.33 me sipërfaqe 200m2 shitur shtetasit Gjergj Pepa;

13-pasuria nr.211/9, vol.1, fq.45 me sipërfaqe 1000 m2 shitur shtetasit Shpend Burgaj;

14-pasuria nr.68/2, vol.1, fq.115 me sipërfaqe 1300 m2 shitur shtetasit Zef Preçetaj;

15-pasuria nr.211/13, vol.8, fq.45, me sipërfaqe 800m2 shitur shtetasit Xhavit Kasemi;

16-pasuria nr.211/12, vol.1, fq.96, me sipërfaqe 900m2 shitur shtetasit Gjergj Pepa;

17-pasuria nr.211/17, vol.1, fq.107, me sipërfaqe 210m2 shitur shtetasit Qemal Duka;

Aktualisht në pronësi të shtetasit Nik Gjergj Purashaj ndodhen ende pasuria nr.211/13, vol.1, fq.95 me sipërfaqe 800m2, pasuria nr.211/15, vol.1, fq.99 me sipërfaqe 1800m2, pasuria nr.211/16, vol.1, fq.100, me sipërfaqe 2300m2 dhe pasuria nr.211/24, vol.8, fq.46 me sipërfaqe 12 990m2.

Nga KKKP –ish Pronarëve Rrethi Malësi e Madhe, i përbërë nga shtetasit Tom Curri, krvelar, Col Gjoni, nënkryetar, Rita delaj, Ruzhdi Mandraj dhe Faik Kurtulaj,

antare, rezultoi të jetë marrë gjithashtu edhe vendimit nr. 20 datë 21 Maj 2001 në favor të shtetasit Nik Mark Pacaj me anë të të cilit i është njohur dhe kihyer këtu të fundit një sipërfaqe pylli prej 18 900 m2 (tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) si më poshtë: 1) parcela me numër 196 me sipërfaqe 7500 (shtatë mijë e pesëqind) metra


katrore që kufizohet : para rruga e kampit, prapa shtet dhe prona e Saluator Kurtit, parcela 204 përkatesisht me

sipërfaqe 11 400 ( njëmbëdhjetë mijë e katërqind mijë) metra katrore që kufizohet me majtas shtet, djathtas rrugë dhe pronat e Tefe Pogut. 2) Parcela 204 përkatesisht me

sipërfaqe 11 400 ( njëmbëdhjetë mijë e katërqind mijë) metra katrore që kufizohet me majtas shtet, djathtas shpja e Lec Cobës , majtas Zef Kurtit e rezervuari I shtetit, të gjitha këto sipas skicave kadastrale. <sup>4</sup> Ky vendim rezultoi të

<sup>4</sup> Cituar me ndryshime VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001.

8





Jetë shkruar me makinë shkrimi, numri, data dhe nr. i protokollit është plotësuar me stilolaps me bojë ngjyrë blu, është firmosur nga kryetari Tom Curri me stilolaps me bojë ngjyrë të zezë dhe antarët Ruzhdi Mandraj, Rita Delaj dhe Faik Kurteshi me stilolaps me bojë ngjyrë blu ndërsa nënkryetari Col Gjoni nuk ka firmosur, është i pa shogëruar me planvendosjen përkatëse dhe si dokumentacion për kthimin e pronës është përdorur (*cituar në vendim*) vërtetim i pronësitë të gjëndjes kadastrale datë 13 Nëntor 2000 shogëruar me planvendosjen përkatëse sipas të cilës prona nuk ka pësuar ndryshime nga gjëndja kadastrale e datës 01 Gusht 1991 dhe është në gjëndje pylli.

Nga korespondenca e mbajtur me Agjensinë e Trajtimit të Pronave, Tiranë rezulton se pranë saj nuk ndodhet i administruar VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 në formën e tij origjinale. Nga kqyrja e dokumentacionit të administruar pranë këtij institucioni rezulton se nga vitit 1993 deri në vitin 2001 nga VKKKP –ish Pronarëve Rrethi Malësi e Madhe janë marrë 125 vendime dhe vendimi me nr.20 mban datën 4 Gusht 1994, ai është i administruar në dosjen me nr.47 dhe është dhënë në favor të shtetasit Koi Lutati.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi **Tom Curri** ka deklaruar se VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 është firmosur prej tij por nuk sqaron faktin përse nuk gjendet dosja e plotë e këtij vendimi.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi **Col Gjoni** ka deklaruar se VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 në emër të shtetasit Nik Mark Pacaj nuk është marrë nga VKKKP ish-Pronarëve, Malësi e Madhe

Të pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale shtetasi **Faik Kurtulaj dhe Ruzhdi Handraj** kanë deklaruar se firma në VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 nuk është hedhur prej tyre. Madje emri i shtetasit Ruzhdi Handraj është shkruar gabim Mandraj.



Sipas aktit të ekspertimit grafik nr. 7607 datë 14 Korrik 2017 të hartuar nga Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë rezultoi se: 1) Nënshkrimi (firma) poshtë emrit Rruzhdri Mandraj që gjendet në rekuiziten "Aniar", tek dokumenti i titulluar "VENDIM" i KKKP të rethit Malësi e Madhe me nr.20 datë 21.05.2001, objekt ekspertimi, nuk është nënshkruar nga shtetasi Ruzhdi Handraj, krahasuar me modellet e lira dhe eksperimentale të nënshkrimit të marra në emër të këtij shtetasi. 2) Nënshkrimi (firma) poshtë emrit të shtetases Rita Delaj që gjendet në rekuiziten "Aniar", tek dokumenti i titulluar "VENDIM" i KKKP të rethit Malësi e Madhe me nr.20 datë 21.05.2001 objekt ekspertimi nuk është nënshkrimi i shtetases Rita Delaj, krahasuar me modellet e nënshkrimit të paraqitura në emër të saj. 3) Nënshkrimi (firma) poshtë emrit të shtetasi Faik Kurtulaj që gjendet në rekuiziten "Aniar", tek dokumenti i titulluar "VENDIM" i KKKP të rethit Malësi e Madhe me nr.20 datë 21.05.2001 objekt ekspertimi, nuk është nënshkruar nga shtetasi Faik Kurtulaj, krahasuar me modellet e lira dhe eksperimentale të nënshkrimit të marra në emër të këtij shtetasi. 4) Në lidhje me pyetjen nëse janë shkruar nga shtetasi Tom Curri, nënshkrimet (firma) që gjenden poshtë emrave, Rruzhdi Mandraj, Rita Delaj dhe Faik Kurtulaj tek dokumenti objekt ekspertimi i titulluar, "VENDIM" i KKKP të rethit Malësi e Madhe me nr.20 datë 21.05.2001, objekt ekspertimi, është nënshkruar nga shtetasi Tom Curri, krahasuar me modellet e lira dhe eksperimentale të nënshkrimit të marra në emër të këtij shtetasi. 6) Shenja e vulës së njomë rrethore me përmbajtje "REPUBLIKA E SHQIPËRISE-PREFEKTURA E QARKUT- RRETHI MALESI EMADHE", gjëndur në krah të rekuizites "Kryetar" tek dokumentin e titulluar, "VENDIM" me Nr.20, datë 21.05.2001 e KKKP, të rethit Malësi e Madhe, është formuar nga e njëjta klishe vulë që ka formuar edhe shenjat e vulave më të njëjten përmbajtje të ndodhura në dokumentet modele të lira krahasimi të titulluara, "Vendim" me Nr.46, datë 29.12.2000, i KKKP Pronave të Rrethit Malësi e Madhe, dhe "Vendim" me Nr. 75, datë 25.04.2000, i KKKP Pronave të Rrethit Malësi e Madhe".



*[Handwritten signature]*

Ndërkohë, nga kqyrja e dokumentacionit të administruar në Zyren Vendore të regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Malësi e Madhe rezultoi se VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 në emër të shtetasit Nik Mark Pacaj në formën e tij origjinale ndodhet i administruar në referencën nr. 006 të zonës kadastrale 3834. Ky vendim, bashkëlidhur të cilit ndodhet një plan rilevimi i hartuar nga inxhinier gjeodet Genc Urugi dhe vulosur me vullë të njomë të Rrethit të Malësisë së Madhe, rezultoi të jetë regjistruar në nr.hipotekor nr.67 datë 15 Shkurt 2002, pasuria nr. 204 me sipërfaqe 11400m2, dhe nr.hipotekor nr.68 datë 15 Shkurt 2002, pasuria nr.196 me sipërfaqe 7500m2.

Pasuritë e regjistruara në nr.hipotekorë 67 dhe 68 datë 15 Shkurt 2002 janë regjistruar më pas në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe referuar kartelave të pasurive konstatohet se pas ndarjes së tyre ato janë tjetërsuar tek personat e tretë si më poshtë vijon:

- 1-Pasuria nr.204/1,vol.1, fage 22, me sipërfaqe 350m2 shitur shtetasit Adem Alivodaj;
- 2-Pasuria nr.204/2, vol.1, fage 26, me sipërfaqe 2100m2 shitur shtetasit Federik Derza;
- 3-Pasuria nr. 204/5, vol.1, fage 20, me sipërfaqe 3000m2 shitur shtetasit Uçe Derza etj.
- 4-Pasuria nr.204/8,vol.1, fage 50, me sipërfaqe 1500m2 shitur shtetasit Vladimир Sterkaj;
- 5-Pasuria nr.204/11,vol.1,fage 76, me sipërfaqe 500m2 shitur shtetasit Vladimир Sterkaj;
- 6-Pasuria nr. 204/9, vol. 1, fage 77, me sipërfaqe 500m2 shitur shtetasit Kreshnik Preka;
- 7-Pasuria nr. 204/10, vol. 1, fage 78, me sipërfaqe 500m2 shitur shtetasit Hajrie Begaj;
- 8-Pasuria nr. 2196/4, vol.1, fq 80, me sipërfaqe 1000m2 shitur shtetasit Lulzim Pacaj.



11

Aktualisht në pronësi të shtetasit Nik Mark Pacaj ndodhet e regjistruar pasuria me nr. 196/1, vol.1, fage 79, me sipërfaqe **5200m2**.

I pyetur në cilësinë e personit që ka dëjani për veprën penale shtetasi **Genc Uruqi** ka deklaruar se është i licensuar si ekspert inxhinier gjeodet por plani i rilevimit bashkëlidhur VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 nuk është hartuar prej tij dhe nuk e ka idenë se kush e ka plotësuar dhe nënshkruar atë.

Në dojen e këtij procedimi penal janë administruar edhe dy vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Malësi e Madhe konkretisht vendimi nr.207 datë 5 Prill 1994 dhe nr. 128 datë 6 Maj 1996 me anë të të cilëve është vërtetuar fakti juridik i pronësisë së shtetasit Mark Pacaj mbi : 1) një shtëpi banimi të ndodhur në Razëm të Vrrithit, dy katëshe e përbërë me tre dhoma me përmasa 16x6.5m dhe kufizohet : përpara me rrugë, prapa me kullotë, majtas me Zef Pogun, djathtas me Valentin Gjeton; 2) një sipërfaqe trualli prej 600m2 në Razëm të Vrrithit që kufizohet : Jug me pronën e Valentin Gjeton, veriu me pyll pishash, perëndim me pronën e Zef Pogut dhe Nik Pacaj dhe lindja kullote. Këto dy vendime gjyqësore kanë shërbyer si dokumentacion për marrjen e vendimit nr.99 datë 25 Shkurt 1997 nga KKKP ish-pronarëve, Rrethi Malësi e Madhe në favor të ish-pronarit shtetasit Mark Pacaj.

Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore të lartpërmendura nuk rezulton që nga shtetasi Nik Mark Pacaj të jetë depozituar ndonjë dokument apo të jetë kërkuar vërtetimi i faktit juridik të pronësisë për një sipërfaqe pylli prej 18 900 m2, pronë e cila është njohur dhe kthyer me VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001.

Nga shqyrtimi i fakteve dhe vlerësimi i akteve dhe provave të administruara në dosjen e këtij procedimi penal rezulton e provar se vendimi nr.19/2 datë 21 Maj 2001 në favor të shtetasit Nik Gjergj Purashaj dhe vendimi nr.20 datë 21 Maj 2001 në favor të shtetasit Nik Mark Pacaj janë të falsifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

**I-VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002** në favor të shtetasit Nik Gjergj Purashaj është marrë në mungesë të plotë të dokumentacionit i ligjit me anë të të cilit të provohet e drejta e pronësisë së ish-pronarit mbi sipërfaqen prej 55 000 m2



(tridhjet e pesë mijë e gjashtë) pyll të ndodhur në Razëm. Dosja e plotë e marrjes së vendimit mungon dhe për rrjedhojë nuk mund të konstatohet dokumentacioni i depozituar dhe i administruar për marrjen e këtij vendimi, madje ky vendim në formën e tij origjinale nuk ndodhet i administruar në Agjensinë e Trafikimit të Pronave, Tiranë. Në vendim përmendet si dokument për vërtetimin e pronësive vetëm një vërtetim kadastral dhe planvendosja bashkëlidhur të cilët në mungesë të vendimit të gjykatës për vërtetimin e faktit juridik apo të dokumentave të tjera të pronësive nuk mund të shërbejë si provë e mjaftueshme për kthimin e pronës së pretenduar. VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 i mungon planvendosja bashkëlidhur e cila është e domosdoshme për identifikimin dhe pozicionimin e saktë gjeografik të pronës në hartën treguese të regjistrimit si dhe sipërfaqen e saj. Prona i është kthyer vetëm shtetasit Nik Gjergj Purashaj ndërkohë që ai rezultoi të ketë lindur në vitin 1948, pra, 3 vjet pas kryerjes së reformës agrare që do të thotë se ish-pronari ishte babai i tij, dhe ka edhe katër vëllezër. Pra, vendimi është marrë pa u gelur dëshmia e trashëgimisë për të ndjerin Gjergj Purashaj që llogjikisht duhet të ishte ish-pronari.

**2-VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002** në favor të shtetasit Nik Gjergj Purashaj është firmosur vetëm nga kryetari i Komisionit shtetas Tom Curti ndërsa antarët e tjerë të komisionit edhe pse përmenden në vendim nuk kanë nënshkruar apo firmosur në të. Baza ligjore e përdorur për kthimin e pronës dhe konkretisht ligji nr. 7699 datë 21 Prill 1993 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.560 datë 16 Tetor 1995 është e gabuar pasi ligji nr.7699 datë 21 Prill 1993 "**Per Kompesimin ne vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore**" dhe vendimi i keshillit të ministrave datë në bazë dhe për zbatim të tij ka si objekt të tij njohjen e të drejtës së pronësive për efekt kompensimi në vlerë të tokës bujqësore ish-pronarëve, personave fizike e juridike, që e kanë pasur atë në pronësi në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945 "**Per reformën agrare**"<sup>5</sup> ndërkohë që në rastin konkret komisioni duhet të kishte përdorur si bazë ligjore ligjin nr. 7917 datë 13 Prill 1995 "**Per kullotat dhe livadhet**" i shtuqizuar, në nenin 4 të të cili ka si objekt administrimin, kthimin ish-


<sup>5</sup> Shiko nenin 1 të ligjit.



pronarëve, përdorimin me kritere të drejta, trajtimin, rritjen e aftësisë mbajtëse dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të kuillotave dhe livadheve.<sup>o</sup>

**3-VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002** rezulton të jetë shkruar me kompjuter ndërkohë që referuar deklaratimeve të nënkryetarit të asaj kohe **Col Gjonaj** rezulton se nga viti 1993 deri në vitin 2001 asnjë prej vendimeve të komisionit nuk është shkruar me kompjuter por me makinë shkrimi prej tij ose shtetasit Faik Kurtulaj dhe asnjëri prej tyre se ka shkruar këtë vendim. Vendimi ka nr.19/2 dhe datën 21 Maj 2002. Nga shqyrtimi i disa prej vendimeve të dhëna nga KKKP ish-Pronarëve, Malësi e Madhe ndër vite konstatohet se nga viti 1993 deri në vitin 2001 nga ky komision janë dhënë 125 (njëqind e njëzet e pesë) vendime të cilat janë në rend kronologjik që do të thotë psh: se pas vendimit nr.80 datë 12.12.1999 vendimi i parë i marrë në vitin pasardhës dmth në vitin 2000 ka numrin 81. Disa prej vendimeve janë me fraksione por gjithmonë ato kanë lidhje me vendimin bazë i cili është një numër i plotë. Ky rregull dhe kjo kronologji nuk është evidentuar dhe për rrjedhojë respektuar në rastin e marrjes së vendimit nr.19/2 datë 21 Maj 2002 i cili nuk është në rend kronologjik me vendimin paraardhës dhe nuk ka lidhje fare me vendimin bazë që ka numrin 19 i cili nuk i përket as shtetasit Nik Gjergj Purashaj dhe as vitit 2002. Ndërsa data është korrigjuar viti nga 2002 në 2001 fakti që provohet jo vetëm nga shqyrtimi me sy të lirë i vendimit por edhe nga akti i ekspertimit grafik nr. 7607 datë 14 Korrik 2017 të hartuar nga Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë. Ky korrigjim është bërë për shkak se në fund të vitit 2001 KKKP ish -Pronarëve Rrethi Malësi e Madhe është suprimuar dhe kompetencat dhe arkiva e tij i kanë kaluar KKKP ish-Pronarëve në Prefekturën e Qarkut Shkodër dhe për rrjedhojë KKKP ish -Pronarëve Rrethi Malësi e Madhe nuk mund të merret me vendime në vitin 2002, vit në të cilin është marrë VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 në favor të shtetasit Nik Gjergj Purashaj. **VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002** është regjistruar në ZVRPP Malësi e Madhe në nr.hipotekorë 166 datë 2 Dhjetor 2002 sipërfaqe 3600 m2 pyll, në nr.hipotekor 167 datë 2 Dhjetor 2002 sipërfaqe 2700 m2 pyll dhe në nr.hipotekor 169 sipërfaqe 22 000m2 pyll. Ky regjistrim është bërë ky regjistrim është bërë pas aplikimit të shtetasit Nik Gjergj Purashaj në datën 2 Dhjetor

<sup>o</sup> Shiko nënin 1 të ligjit.



2002, fakt që provohet me nënshkrimin e tij në librin e pranimit të kërkesave për

regjistrim dhe lëshim gertifikatash, vetëm në bazë të VKKKP ish-pronarëve nr.19/2

date 21 Maj 2002, i cili ndodhet i administruar në formën e tij origjinale në referencën

nr. nr.014 të zonës kadastrale 3834. Bashkëlidhur këtu vendimi nuk ndodhet

dokumentacioni hartografik-teknik i lëshuar nga organi kompetent me qëllim

identifikimin dhe pozicionimin e saktë gjeografik pronës në hartën treguese të

regjistrimit si dhe sipërfaqen e saj por ndodhen vetëm tre plane rilevimi, njëri për

pasurinë nr.211, me sipërfaqe 22 000 (njëzet e dy mijë) m2, një tjetër për pasurinë

nr.68/3 me sipërfaqe të pa pasqyruar dhe plani i tretë i rilevimit nuk ka asnjë të dhënë

të pasurisë së kthyer ish-pronarit. Këto plane rilevimi janë hartuar nga eksperti

inxhinier-geodet Besnik Hysaj dhe janë të vullosura me vullën e njomë të Rrethit të

Malësisë së Madhe, i cili ka deklaruar se planet e rilevimit të administruara në

referencën 014 janë nënshkruar prej tij ndërsa rubrikat e tjera nuk janë plotësuar prej

tij. Sipas aktit të ekspertimit grafik nr. 7607 datë 14 Korrik 2017 të hartuar nga

Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë rezultoi se : **"Dorëshkrimi që gjendet në pjesën**

**e sipërme të skicës së dokumentit objekti ekspertimi të titulluar "Plan-Riveliimi", pa**

**nr.—të pa plotësuar, është shkruar i shtetasit Besnik Hysaj krahasuar me modelet**

**eksperimentale të shkruar të marrë këtu shtetas. Në lidhje me pyetjen nëse**

**dorëshkrimi i plotësimit të rubrikave të gjendura në dokumentin objekti ekspertimi të**

**titulluar "Plan-Riveliimi" me nr.211,të pasurisë në emër të shtetasit Nik Puraashi, është**

**shkruar ose jo nga shtetas Besnik Hysaj, nuk mund të konkludohet".**

**4-Regjistrimi i bërë nga ZVRPP Malësi e Madhe është bërë në kundërshtim me nenin**

**24/1 të ligjit nr.7843 datë 13 Korrik 1994 "Për regjistrimin e pasurive të pa**

**luajtshme" i shtuqizuar, (ligji i kohës) në të cilin parashikohet:"Regjistruesi, një**

**person ose çdo grup i ngarkuar nga kryeregjistruesi kërkon që pronësia si dhe**

**kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen duke përdorur kriteret**

**e mëposhtme: a) Pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga**

**aktet e fitimit të pronësise, sipas nenit 193 të Kodit Civil" pasi regjistrimi i VKKKP**

**ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 është bërë pa u përcjellë zyrtarisht nga**

**institucioni kompetent, pa u kërkuar konfirmim nga institucioni më i lartë hierarkik si**

**dhe në mungesë të dokumentacioni hartografik (planvendosjes) të lëshuar nga organi**

**kompetent i shtetasit Besnik Hysaj.**



kompetent i cili shërben për identifikimin dhe pozicionimin e saktë gjeografik të pronës në hartën treguese të regjistrimit si dhe kufijtë e saj.

**5-Shtetasi Nik Gjergj Purashaj** rezulton të ketë aplikuar për regjistrimin e VKKKP ish-pronarëve nr.19/2 datë 21 Maj 2002 në ZVRPP Malësi e Madhe në datën 2 Dhjetor 2002, fakt që provohet me nënshkrimin e tij në librin e pranimit të kërkesave për regjistrim dhe lëshim certifikatash. Më pas pasuritë e regjistruara në nr.hipotekorë 167,168, dhe 169 datë 2 Dhjetor 2002 kanë kaluar në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe pas ndarjes janë tjetërsuar tek personat e tretë. Aktualisht në pronësi të shtetasit Nik Gjergj Purashaj ndodhen ende pasuria nr.211/13, vol.1, fq.95 me sipërfaqe 800m<sup>2</sup>, pasuria nr.211/15, vol.1, fq.99 me sipërfaqe 1800m<sup>2</sup>, pasuria nr.211/16, vol.1, fq.100, me sipërfaqe 2300m<sup>2</sup> dhe pasuria nr.211/24, vol.8, fq.46 me sipërfaqe 12 990m<sup>2</sup> ndërsa pasuritë e tjera janë tjetërsuar nëpërmjet kontratave të shitjes.

**6-VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001** në favor të shtetasit Nik Mark

Pacaj është marrë në mungesë të plotë të dokumentacionit ligjor me anë të të cilit të provohet e drejta e pronësisë së ish-pronarit mbi sipërfaqen prej 18 900 m<sup>2</sup> (tëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) pyll të ndodhur në Razëm. Dosja e plotë e marrjes së vendimit mungon dhe për rrjedhojë nuk mund të konstatohet dokumentacioni i depozituar dhe i administruar për marrjen e këtij vendimi, madje ky vendim në formën e tij origjinale nuk ndodhet i administruar në Agjensinë e Trajtimit të Pronave, Tiranë. Në vendim përmendet si dokument për vërtetimin e pronësisë vetëm një vërtetim kadastral dhe planvendosja bashkëlidhur të cilët në mungesë të vendimit të gjykatës për vërtetimin e faktit juridik apo të dokumentave të tjera të pronësisë nuk mund të shërbejë si provë e mjaftueshme për kthimin e pronës së pretenduar. VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 i mungon planvendosja bashkëlidhur e cila është e domosdoshme për identifikimin dhe pozicionimin e saktë gjeografik të pronës në hartën treguese të regjistrimit, sipërfaqen dhe kufijtë e saj.

7-Ky vendim rezulton të jetë shkruar me makinë shkrimi, numri , data dhe nr. i protokollit është plotësuar me bojë ngjyrë blu, është firmosur nga kryetari Tom Curri me stilolaps me bojë ngjyrë të zezë dhe antarët Ruzhdi Mandraj, Rita Delaj dhe Faik Kurteshi me stilolaps me bojë ngjyrë blu ndërsa nënkryetari Col



*[Handwritten signature]*



Gjoni nuk ka firmosur. Nga korespondenca e mbajtur me Agjensinë e Trafikimit të Pronave, Tiranë rezultoi se pranë saj nuk ndodhet i administruar VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 në formën e tij origjinale. Nga kqyrja e dokumentacionit të administruar pranë këtij institucioni rezultoi se nga vitit 1993 deri në vitin 2001 nga VKKKP -ish Pronarëve Rrethi Malësi e Madhe janë marrë 125 vendime dhe vendimi me nr.20 mban datën 4 Gusht 1994, ai është i administruar në dosjen me nr.47 dhe është dhënë në favor të shtetasit Kol Lulati. I pyetur në cilësinë e personit që ka dëgjoni për veprën penale shtetasi Tom Curri ka deklaruar se VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 është firmosur prej tij ndërsa antarët e tjerë të komisionit kanë deklaruar se ky vendim nuk është marrë nga VKKKP ish-pronarëve, Malësi e Madhe. Sipas aktit të ekspertimit grafik nr. 7607 datë 14 Korrik 2017 të hartuar nga Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë rezultoi se nënkrimin (firma) në VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 e shtetasve Ruzhdi Mandra, Rita Delaj dhe Faik Kurteshi nuk vendosur nga këta të fundit ndërsa nënkrimin (firma) e shtetasit Tom Curri i përket këtij të fundit. Baza ligjore e përdorur për kthimin e pronës dhe konkretisht ligji nr. nr.7699 datë 21 Prill 1993 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.560 datë 16 Tetor 1995 është e gabuar pasi ligji nr.7699 datë 21 Prill 1993 "Per Kompesimin ne vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave datë në bazë dhe për zbatim të tij ka si objekt të tij njohtjen e të drejtës së pronësisë për efekt kompensimi në vlerë të tokës bujqësore ish-pronarëve, personave fizikë e juridikë, që e kanë pasur atë në pronësi në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945 "Per reformën agrare" ndërkohë që në rastin konkret komisioni duhet të kishte përdorur si bazë ligjore ligjin nr. 7917 datë 13 Prill 1995 "Per kullorai dhe livadher" i shfuqizuar, në nenin 4 të të cili ka si objekt administrimin, kthimin ish-pronarëve, përdorimin me kritere të drejta, trajtimit, rritjen e aftësisë mbajtëse dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të kullotave dhe livadheve.<sup>8</sup>

8-VKKKP ish-pronarëve nr.20 datë 21 Maj 2001 ndodhet i administruar në referencën nr. 006 të zonës kadastrale 3834 në ZVRPP Malësi e Madhe. Ky vendim.

<sup>7</sup> Shiko nenin 1 të ligjit.  
<sup>8</sup> Shiko nenin 1 të ligjit.



bashkëlidhur të cilit ndodhet një plan rilevimi i hartuar nga inxhinier gjedot Genc

Urquj dhe vulosur me vullë të njomë të Rrethit të Malesisë së Madhe, rezultat të jetë

regjistruar në nr.hipotekor nr.67 datë 15 Shkurt 2002, pasuria nr. 204 me sipërfaqe

11400m<sup>2</sup>, dhe nr.hipotekor nr.68 date 15 Shkurt 2002, pasuria nr.196 me sipërfaqe

7500m<sup>2</sup>. Regjistrimi i bërë nga ZVRPP Malesi e Madhe është bërë në kundërshtim

me nenin 24/1 të ligjit nr.7843 datë 13 Korrik 1994 "Për regjistrimin e pasurive të pa

luajtshme" i shtuqizuar, (ligji i kohës) në të cilin parashikohet: "Regjistruesi, një

person ose çdo grup i ngarkuar nga kryeregjistruesi kërkon që pronësia si dhe

kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen duke përdorur kritere

e mëposhtme: a) Pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga

aktet e fitimit të pronësise, sipas nenit 193 të Kodit Civil" pasi regjistrimi i VKKKP

ish-pronareve nr.20 datë 21 Maj 2001 është bërë pa u përcjellë zyrtarisht nga

institucioni kompetent, pa u kërkuar konfirmim nga institucioni më i lartë hierarkik si

dhe në mungesë të dokumentacioni hartografik (planvendosjes) të lëshuar nga organi

kompetent i cili shërben për identifikimin dhe pozicionimin e saktë gjeografik të

pronës në hartën treguese të regjistrimit si dhe kufijtë e saj. Pasuritë e regjistruara në

nr.hipotekor nr.67 dhe 68 date 15 Shkurt 2002 kanë kaluar në sistemin e ri të

regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe pas ndarjes janë tjetërsuar tek personat e

trretë. Aktualisht në pronësi të shtetasit Nik Mark Pacaj ndodhet ende pasuria 196/1,

vol.1, fage 79, me sipërfaqe 5200m<sup>2</sup> ndërsa pasuritë e tjera janë tjetërsuar nëpërmjet

kontratave të shites.

Sa më sipër, duke qenë se disponimi i lire i pasurive të fituara në mënyrë të

kundraligjshme mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penae ose të lehtësojë

kryerjen e veprave penale të tjera, pasi këto pasuri mund të jenë objekt material i

transaksioneve të ndryshme juridike nga të cilat cënohen interesat ligjore të shtetit si

dhe mund të cënohen interesat ligjor të shtetasve ose personave juridik blerës

pontecial të këtyre pronave të mbrojtura nga ligji penal apo ligjet e tjera, në bazë të

neneve 274, 275 të Kodit të Procedurës Penale;



*[Handwritten signature]*



**BLERTA HAMZA**  
**PROKUROR**

- 1. Urdhër për regjistrimin e procedimit penal;
- 2. Urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore;
- 3. Vendim për sekuestrimin e provës materiale;
- 4. Vendim për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave;
- 5. Vendim për kryerjen e ekspertimit grafik dhe akti i ekspertimit nr. 7607 datë 14 Korrik 2017 të hartuar nga Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë;
- 6. Procesverbal për pyetjen e personave që kanë dijeni për veprën penale;
- 7. Dokumentacioni dhe informacioni i vënë në dispozicion nga ZVRRP, Malësi e Madhe, Agjensia e Trajtimit të Pronave, Tiranë etj.

❖ Bashkëlidhur kësaj kërkesë vemë në dispozicion të gjykatës të gjitha aktet dhe provat e administruara në fashikullin e procedimit penal nr.421 datë 10 Mars 2016:

nr.19/2 datë 21 Maj 2001 (2).

2- Për pasuritë me nr.211/13, vol.1, fq.95 me sipërfaqe 800m<sup>2</sup>, nr.211/15, vol.1, fq.99 me sipërfaqe 1800m<sup>2</sup>, nr.211/16, vol.1, fq.100, me sipërfaqe 2300m<sup>2</sup> dhe nr.211/24, vol.8, fq.46 me sipërfaqe 12 990m<sup>2</sup> si dhe çdo pasuri tjetër e cila ka rryedhur nga regjistrimi i bërë në nr.hipotekor 166 datë 2 Dhjetor 2002, në nr.hipotekor 167 datë 2 Dhjetor 2002 sipërfaqe 2700 m<sup>2</sup> pyll dhe në nr.hipotekor 169 sipërfaqe 22 000m<sup>2</sup> pyll në bazë të VKKKP ish-pronarëve

nr.20 datë 21 Maj 2001.

1- Për pasurinë me nr. 196/1, vol.1, fage 79, me sipërfaqe 5200m<sup>2</sup>, aktualisht në pronësi të shtetasit Nik Mark Pacaj si dhe çdo pasuri tjetër e cila ka rryedhur nga regjistrimi i bërë në nr.hipotekore nr.67 datë 15 Shkurt 2002 dhe nr.hipotekor nr.68 date 15 Shkurt 2002 në bazë të VKKKP ish-pronarëve

Lëshimin e urdherit të sekuestrimit :

**KËRKOJ:**